

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektvendimi “Për miratimin e planit të veprimit 2023-2025 në zbatim të Strategjisë kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda 2021-2025, të ndryshuar”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Në zbatim të urdhrit të ministrit të Brendshëm nr. 65, datë **12.05.2022** “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të veprimit të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda”,

Takimi i parë i grupit të punës dhe pikave të kontaktit të institucioneve, për hartimin e planit të veprimit 2023-2025 në zbatim të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të rënda, 2021-2025 është zhvilluar më datë 21.07.2022 në ambientet e Ministrisë së Brendshme, nën koordinimin dhe kryesimin e zëvendësministrit të Brendshëm.

Gjatë procesit të hartimit të planit të veprimit, me strukturat teknike janë bërë takime edhe në muajin nëntor të vitit 2022, në Agjencinë e Administrimit të Pronave të Sekuestruara dhe Konfiskuara dhe në Policinë e Shtetit.

Konsultimi publik nëpërmjet publikimit në RENJK do të zgjasë nga data 07 dhjetor 2022 deri më 26 dhjetor 2022.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektvendimin “Për miratimin e planit të veprimit 2023-2025 në zbatim të Strategjisë kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda 2021-2025, të ndryshuar” ishin tre:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK;
2. Takime të grupit të punës;
3. Email.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

Anëtarët e grupit të punës, në bazë të urdhrimit nr. 63, datë 12.05.2022 të ministrit të Brendshëm:

- Drejtori i Politikave dhe Strategjive, në drejtorinë e Politikave dhe Strategjive, në Drejtorinë e Përgjithshme për Politikën e Rendit dhe Sigurinë Publike;
- Përgjegjësi i Sektorit të Hartimit dhe Koordinimit të Strategjive, në drejtorinë e Politikave dhe Strategjive;
- Specialist në Sektorin e Politikave dhe Programeve të Zhvillimit;
- Përfaqësues i Sektorit të Buxhjetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse;
- Përfaqësues i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Përputhshmërisë;
- Përfaqësues i Sektorit të Bashkëpunimit, Marrëveshjeve dhe Kontratave në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Përputhshmërisë;
- Përfaqësues i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Drejtorinë e Përgjithshme për Politikën e Rendit dhe Sigurinë Publike;
- Përfaqësues i Sektorit të Narkotikëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH);
- Përfaqësues i Sektorit kundër Trafikeve;
- Përfaqësues i Sektorit për Krimin Ekonomik;
- Përfaqësues i Sektorit kundër Pastrimit të Parave dhe Aseteve;
- Përfaqësues i Sektorit kundër Krimeve ndaj Personit;
- Përfaqësues i Sektorit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
- Dy përfaqësues (buxheti dhe burimet njerëzore) nga drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në DPPSH;
- Përfaqësues nga Instituti i Policisë Shkencore;
- Përfaqësues nga Sektori ZKQ Interpol;
- Përfaqësues i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Gjithashtu edhe:

- Koordinatorin për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I	Justifikimi
--------------------	---------	---------------------	----------------------	-------------

<i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	<i>(grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	<i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	pranuar pjesërisht/I refuzuar)	